

TITULLI I PROJEKTIT

LOTI 1: "HARTIM I PROJEKT PREVENTIVAVE TË ZBATIMIT PËR DISA SPITALE RAJONALE DHE BASHKIAKE"
SPITALI RAJONAL GJIROKASTER

KLIENTI**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE****GRUPI I PROJEKTIMIT**


ATELIER 4
ARCHITECTURE & CONSULTING STUDIO

Rr. e "Kosovarëve", Ndërtesa 35, Hyrja 6, Ap.4/1,
Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri
tel: +355 4 24 30 195 / 4 22 22 804
fax: +355 4 24 30 194
mobile: +355 69 20 38 958
e-mail: info@atelier4.al
web: www.atelier4.al

ARCHIMED S.P.S

ARCHIMED S.P.S
CONSULTING & ENGINEERING STUDIO

Rr. "Zef Jubani", Pallati Bjom, Nr. 7/3,
Tiranë, Shqipëri
tel / fax: +355 4 24 33 202
mobile: +355 69 21 05 507
e-mail: info@archimedspss.com
e-mail: archimedspss@gmail.com
web: www.archimedspss.com



KEJSI-05
CONSULTING & ENGINEERING STUDIO

Rr. "Zef Jubani", Ndërtesa 7, Ap. 3, Tiranë, Shqipëri
mobile: +355 68 40 38 122
mobile: +355 68 20 77 941
e-mail: info@kejsi05.com
web: www.kejsi05.com

KODI I DOKUMENTIT**NR. I VIZATIMIT**

SRB . D . A . 0 . 0
KODI FAZA DISIPLINA KATI RISHIKIM

A - 00**EMËRTIMI I DOKUMENTIT****RELACIONI ARKITEKTONIK**

DATA

SHKURT 2019

**PËRSHKRIMI I FAZËS
PROJEKT ZBATIM**

RISHIKIM

DATA

FAZA E PROJEKTIT

RISHIKIM

DATA

FAZA E PROJEKTIT

Tabela e përmbajtjes

1.	HYRJE	2
2.	Q ËLLIMI I SHËRBIMIT	2
2.1.	OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM.....	2
2.2.	OBJEKTIVI I SPECIFIKE.....	3
3.	ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE E KOMPLEKSIT SPITALOR	3
3.1.	RRUGET, HYRJET DHE AMBJENTET E JASHTME	3
3.2.	SITUATA EKZISTUESE E ARKITEKTURËS	5
3.3.	TË DHËNA TEKNIKE.....	7
4.	STRATEGJIA E NDËRHYRJES.....	8
4.1.	HYRJET DHE SISTEMIMET E JASHTME	8
4.2.	PLANET ARKITEKTONIKE, RIFINITURAT	9
5.	PUNIMET DHE NDËRTIMET	10
5.1.	FAZAT E PUNIMIT	10
5.2.	TABELA PERMBLEDHËSE	10

1. HYRJE

Bashkimi i konsulentëve "ATELIER 4" sh.p.k, "ArchiMED SPS" sh.p.k, dhe "KEJISI-05" sh.p.k, është kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) për ekzekutimin e Kontratës së Shërbimeve Konsulente për: **Loti 1 "Hartim i projekt preventivave të zbatimit për disa Spitale Rajonale dhe Bashkiake"**.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka ndërmarrë realizimin e projekt-preventivave të zbatimit për disa nga spitalet rajonale dhe të distrikteve dhe përkatësisht:

- o Spitali Rajonal Berat
- o Spitali Rajonal Gjirokastrë
- o Spitali Rajonal Lezhë
- o Spitali Bashkiak Pogradec
- o Spitali Mat

Qëllimi i raportit të Projektit është një përmbledhje e konkluzioneve të fazës së studimit , përshkrim i procesit të zhvillimit të Projektit si dhe detajim i zgjidhjeve funksionale dhe teknike .

2. QËLLIMI I SHËERBIMIT

2.1. OBJEKTIVI I PERGJITHSHËM

Qëllimi i Projektit është të kontribuojë për përmirësimin e efikasitetit të kujdesit shëndetësor në spitalet e përzgjedhura në Shqipëri, të përmirësojë menaxhimin e informacionit në sistemin shëndetësor dhe të rrisë aksesin financiar tek shërbimet shëndetësore. Shërbimet që kërkohen të kryhen në kuadrin e Termave të Referencës kanë të bëjnë me: përmirësimin e infrastrukturës spitalore, punime përmirësimi, mobilimi dhe përmirësime të infrastrukturës së godinave/shërbimeve, mbi bazën e një plani strategjik të hartuar nga autoritetet administrative të spitalit.

Strukturat ekzistuese do t'i nënshtrohen përmirësimeve, rinovimeve dhe zgjerimit që do të bëjnë të mundur modernizimin dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimit.

2.2. OBJEKTIVA SPECIFIKE

Objektivi i përgjithshëm i projektit është rinovimi i godinës ekzistuese të **Spitalit Rajonal Gjirokastër**, si dhe krijimi i një ure lidhëse midis spitalit dhe maternitetit ekzistues të vendosur në brendësi të kampusit spitalor.

Për të arritur objektivin e përgjithshëm të projektit në vijim janë dhënë pritshmëritë kryesore që do të arrihen nga Konsulenti:

- Vlerësimi teknik i ndërtesave ekzistuese si dhe studimet e projektit Arkitektonik e Inxhinierik
- Perlllogaritja e Kostotve Paraprake
- Raporte teknike

3. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE E KOMPLEKSIT SPITALOR

3.1. RRUGËT, HYRJET DHE AMBIENTET E JASHTME

Kompleksi i Spitalit Rajonal Gjirokastër është i vendosur në pjesën Veriore të qytetit të Gjirokastrës dhe është i përbërë nga nëntë godina, respektivisht të quajtura:

Spitali Rajonal Gjirokastër "Omer Nishani"

Materniteti "Dhimitër Cuci"

Autopsia

Garazhet

Oficina

Oksigjeni

Lavanteria

Sterilizimet

Morgu

Korpusi spitalor është i akseueshëm nga vetëm një hyrje kryesore, nga ku shpërndahen vizitoret e ndryshëm. Pjesa e urgjencës është e inkuorporuar në godinën e spitalit kryesor dhe ka hapësira parkimi të posacme për ambulancën. Parkimet nuk janë të ndara për përdorues të ndryshëm edhe pse numri i tyre është relativisht i lartë. Gjithashtu godina e spitalit përfshin edhe poliklinikën e cila aksesohet në pjesën e pasme të kompleksit.

Godinat një katëshe në pjesën perëndimore të korpusit janë të rrënuara.



Fig.1 _ Foto ajrore e Kompleksit Spitalor



Fig.2 _ Hyrje kryesore e Urgjences(majtas) dhe Hyrja dytesore e spitalit (djathtas).



Fig.3 _ Hyrje e Spitalit (majtas) dhe Hapësira e maternitetit (djathtas).

3.2. SITUATA EKZISTUESE E ARKITEKTURËS.

Godina Kryesore e Spitalit është e përbërë nga tre kate mbitokë dhe një kat i konsideruar nëntokë, ku për shkak të ndryshimeve të relievit ka hyrje të drejtpërdrejta në koten e plansistemimit. Sipërfaqja totale është 8247 m².

Ai përmban këto funksione:

Kati -1_ Laboratori, Radiologjia, Farmacia, Kuzhina

Kati 0_ Pediatri, Poliklinike, Urgjenca

Kati 1_ Kirurgjia

Kati 2_ Patologjia, Infektivi

Godina ka tre hyrje, të cilat i referohen funksioneve të ndryshme. Hyrja e ambulancës është e shoqëruar edhe me rampë, gjë që lehtëson lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara. Hyrja e spitalit dhe e poliklinikës aksesohen vetëm me shkallë.

Gjatë vizitës në vend u verifikua gjëndja e përgjithshme e spitalit, ku u konstatuan kushte jo të mira në tavanet e varura, lageshtire e cila vjen nga mungesa e izolimit dhe drenazhimit të mureve në kuotën zero. Gjithashtu tualetet janë të papërshtatshme për personat me aftësi të kufizuara dhe kanë nevojë për rikonstruksion të plote.



Fig.4 _ Koridor në spital (majtas) dhe Drejtori (djathtas)



Fig.5 _ Dhomë pacienti (majtas) dhe Kuzhina (djathtas)



Fig.6 _ Hapësirë ne podrum (majtas) dhe Hapësira e laboratorit (djathtas)



Fig.7 _ Ballkonet (majtas) dhe Hapësira e podrumit (djathtas)

3.3. TË DHËNA TEKNIKE

Nr.	Informacion teknik në lidhje me godinen kryesore te spitalit		Njësi	Sasi	Informacion teknik specifik
1.	Sipërfaqja totale e objektit	Godina Kryesore e Spitalit	m ²	8247	Sipërfaqe e katit nëntokë 2337m ² Sipërfaqe e katit përdhe 1970m ² Sipërfaqe e katit të parë 1970 m ² Sipërfaqe e katit të dytë 1970 m ²
2.	Nr.i kateve te objektit	Godina Kryesore e Spitalit	Kate	3	
3.	Numri i dhomave të operatorëve		Numur	3	
6.	Nr. i Lab dhe sipërfaqja e tyre e përgjithshme	Nr. i Laboratorëve Sip. e brendshme	Copë	2 2	Laborator i analizash
7.	Shërbimi i urgjencës (vendi, kati, nr.i dhomave për kujdesin e pacientëve; dh. e vizitave, dh. e infiermerie etj).	Numuri i dhomave	Copë	3	Urgjenca ndodhet në katin perdhe te godines, me hyrje ne pjesen lindore të godinës. Hyrja shoqërohet me shkallare dhe pantus.
		n. dhoma vizitash	Copë	1	
8.	Informacione të tjera teknike	Ashensorët		1 Ashensori për të gjithë përdoruesit (k-1, k0, k1, k2,)	
9.		Sipërfaqe parkimi	m ²	438m ²	
		Zonë e gjelbër	m ²	7333m ²	
		Sipërfaqe rruge	m ²	9802m ²	

4. STRATEGJIA E NDERHYRJES



Principi mbi të cilin është bazuar koncepti është shpjeguar si më poshtë:

Godina kryesore e spitalit do të ketë rikonstruksion total, për arsye të kushteve jo të favorshme arkitektonike. Ndërtesa ekzistuese e oksigjenit do të priset dhe do të ndërtohet një godinë një katëshe ku përfshihen gazi medical, vakumi dhe oksigjeni. Strukture 1 katëshe betoni e mbuluar me llamarinë të valëzuar.

Gjithashtu kati i fundit i spitalit do të lidhet me një urë, me maternitetin, për të përmirësuar lëvizjen e përdoruesve.

Ambjentet e brëndshme do të riformulohen për një përdorim sa më eficient të hapësirës dhe kohës lëvizëse nga një funksion në tjetrin.

Projekt ideja e propozuar lejon mundësinë e përdorimit dhe menaxhimin sa më eficient të kompleksit spitalor.

4.1. HYRJET DHE SISTEMIMET E JASHTME

Rehabilitimi dhe përmirësimi i përgjithshëm i kompleksit do të përfshijë rikonceptimin e lulishteve rreth e rrotull spitalit, parkimeve dhe rrugëve të brëndshme.

Parkimet e ambulancës do të qëndrojnë në të njëjtin pozicion dhe do ti dedikohen dhe pesë vende të tjera për zonën e urgjencës. Ndërkohë janë pozicionuar 12 vende parkimi për vizitorët në zonën jugore dhe 8 për stafin në pjesën perëndimore.




Fig.3 _ Plani i përgjithshëm i objekteve ekzistuese dhe të propozuar

4.2. PLANET ARKITEKTONIKE, RIFINITURAT

Nga pikpamja arkitektonike përmirësimi në Godinën Kryesore Spitalore ka të bëjë me ndërhyrje të shpërhapura në të gjithë godinën si, rikonstruktimi i të gjithë nyjeve sanitare, vendosja e pedenat për njerëzit me aftësi të kufizuara, riparimet e tavaneve të varura, dritareve dhe grilave të aluminit, riparime të shtresave të dyshemesë, veshje fasadës së jashtme me sistem kapote.

Fasada e strukturës ekzistuese do të jenë me mur të suvatuar e të lyer me bojë në anën e brendshme, në anën e jashtme me një shtresë izolimi termik prej 10 cm; fasada do të ketë një rifiniturë me suva me ngjyra të ndryshme, të pershtatshme për një kompleks spitalor.

Izolimi termik i fasadës është prej panelesh me lesh guri me veshje të fortë prej fibrash minerare me dendësi të lartë, përcjellshmëria termike $\lambda 0.035 \text{ Ę/mK}$, koeficienti i rezistencës ndaj depërtimit të avujve $>10\text{kPa}$, Presioni në 10% shtypje $> 30\text{kPa}$, klasa A1 - material jo i djegshëm - reagimi ndaj zjarrit.

Duke marrë parasysh funksionin e ndërtesës dhe tipologjinë e saj, grupi projektues ka qenë shumë i kujdesshëm në përdorimin e filozofisë së ngjyrave dhe moduleve të thjeshta.



Fig.4 _ Fasada kryesore e spitalit

Funksionet ne godinë nuk do te ndryshojne, por do të riformulohen funksionet ekzistuese. Dhomat e pacienteve jane programuar me tualet te vecante dhe gjithashtu me max 2 krevate per dhome.

Ne godinë jane shtuar dy ashensore, njëri për paciente ne hyrjen kryesore dhe tjetri me i madh per qarkullimin e pacientëve me krevat. Ne kete menyre ndahet lëvizja midis pacientëve dhe vizitorëve.

Tavani i varur është përdorur në te gjitha ambjentet e brëndshme, me karakteristika specifike bazuar në funksionet, si kundra lagështirës dhe antibakterial në sallat e operacioneve.

Kati -1 me siperfaqe **2337m²** përfshin laboratorin, Radiologjia, Farmacia, Kuzhina.

Kati 0 me siperfaqe **1970m²** përfshin Pediatri, Poliklinike, Urgjenca

Kati 1 me siperfaqe **1970m²** përfshin kirurgjinë

Kati 2 me siperfaqe **1970m²** përfshin pavijonin e patologjisë dhe infektivin

Ura lidhese midis spitalit dhe materniteti me nje gjatesi prej 36.1 m, e veshur me alukobond dhe e mbeshtetur ne kolona betoni, do ndihmoje ne komunikim me te mire midis funksioneve te dy ndertesave.



Fig.5 _ Pamje nga ura lidhese

5. PUNIMET DHE NDËRTIMET

5.1. FAZAT E PUNIMIT

Kompleksiteti punimeve të ndërtimit të parashikuara bazohet në rinovime, plotësime që duhet të koordinohen me minimumin e interferencës së mundshme.

Faza 0 : Studim i terrenit, veçanërisht sa i takon elementëve nëntokësorë (tubacioneve, kablllove , gropave , mbetjeve të objekteve të prishura etj.)për të zbuluar pengesat të cilat nuk janë të dukshme në domomentat e analizuar.

Faza 1 : Përgatitja , rrethimi i kantierit si dhe krijimi i një hyrjeje pa u bere pengese e qarkullimit te brendshëm e cila i shërben makinerive të kantierit dhe grupit të punës.

Faza 2 : Fillimi i punimeve per ndertimin e urës lidhëse.

Faza 3 : Rikonstruksioni i elementëve të jashtëm të godinës ekzistuese si dhe ndërhyrjet: prishje të vogla, përmirësimi i itinerareve të daljeve të sigurisë , zëvendësimi i dritareve, zëvendësimi i dyerve kryesore, përmirësim dhe rindërtime të ndarjeve të brendshme në brendësi , veshje dhe lyerje të mureve të brendshme e të jashtme, riparimi i dyshemeve dhe tavaneve , izolimi termik , izolimi kundra ujit i elementëve të jashtëm të ndërtesës, rikonstruksioni i ambienteve sanitare, etj.

Faza 4 : Sistemimet e jashtme, sipërfagjet e gjelbëruara, hapësirat e parkimit, kalimet dhe rampat e këmbësorëve, muri rrethue

5.2. TABELA PËRMBLEDHËSE

	Godina Kryesore e Spitalit
<i>Sipërfaqe (m²)</i>	8247m ² njolla (kati 0) 1970m ²
<i>Nr i kateve</i>	3 kate dhe 1 kat pjeserisht nëntokë
<i>Funksionet</i>	kati-1 (2337 m²) laborator, radiologjia, farmacia, kuzhina kati 0 (1970 m²) pediatria, poliklinika, urgjenca kati 1 (1970 m²) kirurgjia kati 2 (1970m²) patologjia dhe infektivi